REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E SHËNDETËSISË-MINISTARSTVO ZDRAVLJA-MINISTRY OF HEALTH
Njësia Org.: Org.jedinica: Org. Unit: 02
Nr. Prot: Broj Prot: Prot. No: 05-4800
Nr. i faqeve: Br. stranica: No. pages: -4-
Data: Datum: Date: 08/07/2026
Prishtinë / a

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government
Ministria e Shëndetësisë/Ministry of Health/Ministarstvo Zdravstva

PROCEDURA STANDARDE OPERATIVE

EMRI I PSO: DETEKTIMI I UREAPLASMA UREALYTICUM/MYCOPLASMA HOMINIS DHE REZISTENCA ANTIMIKROBIKE SIPAS TESTIT MYCOPLASMA SYSTEM PLUS (LIOFILCHEM) NË MOSTRAT GJENITALE (ITGJ08/V1.0)

PËRMBAJTJA: DOKUMENTI PËRFSHIN HAPAT KRYESORË TË DETEKTIMIT TE UREAPLASMA UREALYTICUM DHE MYCOPLASMA HOMINIS NË MOSTRAT GJENITALE ME MYCOPLASMA SYSTEM PLUS (LIOFILCHEM), DUKE SIGURUAR QË TESTIMI TË KRYHET NË MËNYRË TË SAKTË DHE TË STANDARDIZUAR

VERSIONI: 1.0
DATA E APROVIMIT: 07.07.2026
AUTOR: MSH/IKSHPK
NR. I HAPAVE: VI
NR. I NËNHAPAVE: 31

APROVUAR: Jahë Gecaj
U.D. Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Shëndetësisë

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA - QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA - MINISTRIA E SHËNDETËSISË - MINISTARSTVO ZDRAVLJA - MINISTRY OF HEALTH
Prishtinë / a

QËLLIMI	QËLLIMI I KËSAJ PSO ËSHTË TË SIGUROJË NJË QASJE TË STANDARDIZUAR PËR DETEKTIMIN E UREAPLASMA UREALYTICUM/MYCOPLASMA HOMINIS DHE REZISTENCA ANTIMIKROBIKE SIPAS TESTIT MYCOPLASMA SYSTEM PLUS (LIOFILCHEM) NË MOSTRAT GJENITALE, DUKE SIGURUAR QË TESTIMI TË KRYHET NË MËNYRË TË SAKTË, TË STANDARDIZUAR DHE NË PËRPUTHJE ME KËRKESAT E MENAXHIMIT TË CILËSISË NË LABORATOR.
NDËRLIDHJA ME AKTET	• LIGJI NR. 08/L-200 PËR PARANDALIMIN DHE KONTROLLIN E SËMUNDJEVE NGJITËSE, • PLANI STRATEGJIK KOMBËTAR PËR LABORATORE 2024-2030; • DORACAKU PËR MENAXHIMIN E CILËSISË NË LABORATORË; • EUCAST CLINICAL BREAKPOINTS AND DOSING OF ANTIBIOTICS 2026.
LISTA E SHKURTESAVE	• PSO - PROCEDURA STANDARDE OPERATIVE; • PPM - PAJISJET PERSONALE MBROJTËSE; • ITGJ- INFEKSIONET E TRAKTIT GJENITAL; • AST – ANTIMICROBIAL SUSCEPTIBILITY TESTING; • CFU – COLONY FORMING UNIT; • UU – UREAPLASMA UREALYTICUM; • MH – MYCOPLASMA HOMINIS.

PROCEDURA

Nr.	HAPI	NËN-HAPAT
[I]	Zbatimi i masave për menaxhim të mostrave	1. Mostra merret nga gjinekologu/urologu ose personeli i trajnuar; 2. Mostra transportohet në laborator sipas kushteve të përcaktuara; 3. Laboranti kryen pranimin dhe refuzimin e mostrës së urinës duke i respektuar kriteret e pranimit të mostrës në bazë të Doracakut për Cilësinë e punës në laborator;
[II]	Reagjentët dhe pajisjet që janë të nevojshme për testim	1. Sigurohu që të gjitha pajisjet dhe reagjentët e mëposhtëm janë të disponueshëm dhe funksional para fillimit të testimit; **1.1 Pajisjet:** a. Flaka e Bunsenit; b. Inkubator 35–37°C; c. Kabinet i sigurisë biologjike Klasa II; d. Mikropipeta automatike; e. Ore (kohematës); f. Frigorifer 2–8°C; g. Vorteks; h. Termometër laboratorik; **1.2 Reagjentët:** a. Mycoplasma System Plus (Liofilchem); b. Mediumi transportues i rekomanduar; c. Kontroll pozitiv; d. Kontroll negativ; **1.3 Materiali:** a. Strisho sterile; b. Tuba sterilë; c. Dorëza njëpërdorimëshe; d. Kontejnerë Biohazard; e. Pajisjet Personale Mbrojtëse (PPM).
[III]	Veprimet laboratorike të marrjes dhe transportit të mostrës	1. Mostra merret nga endocerviksi, uretra, vagina ose urina e parë sipas kërkesës klinike; 2. Strishoja vendoset në mediumin transportues; 3. Mostra etiketohet me: • ID e pacientit; • Datën dhe orën e marrjes; • Llojin e mostrës; 4. Mostra transportohet në laborator sa më shpejt që të jetë e mundur; 5. Mostrat ruhen në 2–8°C deri në përpunim; 6. Mostrat e dëmtuara ose të paetiketuara refuzohen.llojin e mostrës.
[IV]	Veprimet laboratorike të testimit	1. Mostra homogjenizohet sipas udhëzimeve të prodhuesit; 2. Përgatitet suspensioni në mediumin e testimit;

		3. Puset e panelit Mycoplasma System Plus inokulohen me suspensionin e mostrës; 4. Paneli mbyllet dhe etiketohet; 5. Inkubohet në 35–37°C; 6. Leximi i parë kryhet pas 24 orësh; 7. Nëse kërkohet, inkubimi vazhdon deri në 48 orë; 8. Regjistrohen ndryshimet e ngjyrës në puset përkatëse. 9. Vlerësohet prania e Ureaplasma urealyticum dhe/ose Mycoplasma hominis; 10. Interpretohen rezultatet e ndjeshmërisë ndaj antibiotikëve sipas udhëzimeve të kompletit
[V]	Interpretimi i rezultateve	1. Ndryshimi i ngjyrës në puset identifikuese tregon praninë e mikroorganizmave; 2. Rezultati konsiderohet pozitiv për Ureaplasma spp. kur puset specifike japin reaksion pozitiv; 3. Rezultati konsiderohet pozitiv për Mycoplasma hominis kur puset specifike japin reaksion pozitiv; 4. Vlerësohet ngarkesa mikrobiale sipas pragjeve të përcaktuara nga prodhuesi; 5. Rezultatet e AST interpretohen si: a. S = Sensitive (i ndjeshëm); b. I = Intermediate (ndjeshmëri e ndërmjetme); c. R = Resistant (rezistent); 6. Kontrollet pozitive dhe negative duhet të japin rezultatet e pritshme para validimit të serisë;
[VI]	Veprimet e laboratorike të raportimit të rezultatit	1. Laboranti regjistron rezultatet në sistemin laboratorik; 2. Mikrobiologu verifikon dhe validon rezultatet; 3. Raporti përfundimtar përfshin: 3.1.Rezultati negativ: a. Ureaplasma urealyticum –NEGATIV b. Mycoplasma hominis – NEGATIV 3.2.Rezultati pozitiv: a. Ureaplasma urealyticum - POZITIV > 100 000 CFU/ml b. Mycoplasma hominis - POZITIV > 100 000 CFU/ml c. Ureaplasma urealyticum - POZITIV > 100 000 CFU/ml d. Mycoplasma hominis – NEGATIV e. Ureaplasma urealyticum –NEGATIV f. Mycoplasma hominis - POZITIV > 100 000 CFU/ml 4. Antibiotikët raportohen si S, I ose R për secilin mikroorganizëm të izoluar. 5. Raporti nënshkruhet dhe validohet nga mikrobiologu përgjegjës.